



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

UDHËZUES PËR APLIKIM NË THIRRJEN PUBLIKE PËR SUBVENCIONIM ME MJETE FINANCIARE

INICIATIVA PËR FUQIZIM DIGJITAL (IFD)

SKEMA E GRANTEVE PËR DIGJITALIZIM

**Përkrahja e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për
mbulimin e shpenzimeve të transformimit digjital**

**Autoriteti zbatues: Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e
Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe projekti EnInGeP**

Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumenteve përcjellëse:
Nga data 27.03.2024 deri më datë 19.04.2024

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA	3
3. Shërbimet e digjitalizimit dhe madhësia e grantit	3
4. Dokumentet e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018	4
5. Kohëzgjatja.....	5
6. Sqarime shtesë	5
7. Si të aplikohet?.....	5
8. Kriteret e vlerësimit	5
9. Ankesat.....	6

1. Hyrje

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe në bashkëpunim me projektin “Enabling Income Generation for the Poor” (EnInGeP) të financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) fton ndërmarrjet kosovare të bëhen pjesë e Iniciativës për Fuqizim Digjital (IFD) dhe të përfitojnë nga shërbimet për digjitalizim.

Përmes IFD, KIESA ofron një mundësi unike për ndërmarrjet mikro (deri në 9 punëtorë), të vogla (10 deri në 49 punëtorë) dhe të mesme (50 deri në 249 punëtorë) për transformim digjital, me qëllim të rritjes së performancës, konkurrueshmërisë dhe qasjes në tregjet lokale dhe ndërkombëtare.

2. Përkrahja financiare e ofruar nga MINT/KIESA

Shuma totale e projektit është 345,000.00€. Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion. Grantet do të ndahen përmes kategorive si në vijim:

- 80% subvencion për ndërmarrjet mikro deri në 9 punëtorë (60% të përfituesve)
- 70% subvencion për ndërmarrjet e vogla 10 – 49 punëtorë (30% të përfituesve)
- 60% subvencion për ndërmarrjet e mesme 50 – 249 punëtorë (10% të përfituesve).

Shënim:

Në rast që nuk plotësohet kuota e përcaktuar me lart, atëherë teprica e buxhetit mund të bartet tek ndërmarrjet e madhësisë tjetër.

3. Shërbimet e digjitalizimit dhe madhësia e grantit

Shërbimet e digjitalizimit të ofruara në kuadër të IFD-së janë:

- Marketing Digjital
- Burime Njerëzore
- E- Tregtia / Platformat e Shitjes Online
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin (CRM) dhe Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjeve (ERP) dhe
- Programe të ndryshme automatizimi dhe optimizimi

Madhësia e grantit është siç vijon:

- Marketingu Digjital - Madhësia maksimale e Grantit: 2,500 €
- Burime Njerëzore përmes platformave të licencuara - Madhësia maksimale e Grantit: 2,000 €
- E- Tregtia / Platformat e Shitjes Online- Madhësia maksimale e grantit 3,500 €

- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin (CRM) dhe Planifikimi i Burimeve të Ndërmarrjeve (ERP) - Madhësia maksimale e Grantit: 2,500 €
- Programe të ndryshme automatizimi dhe optimizimi - Madhësia maksimale e grantit 4,000 €

4. Dokumentet e kërkuara sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Certifikatën e numrit fiskal (nuk aplikohet për bizneset të cilat numrin e regjistrimit të biznesit dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).
- Vërtetim tatimor me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.
- Listën e punëtorëve për vitin 2023 të lëshuar nga ATK (mund të nxjerrët online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës do të kategorizohen dhe vlerësohen ndërmarrjet si: mikro, të vogël apo e mesme dhe do të vlerësohen piket e punësimit të gjinisë femërore.¹
- Dëshminë mbi qarkullimin vjetor të vitit 2023 dhe 2022 nga ATK.
- Kopjen e letërnjoftimit të personit/ve në emër të cilit/ve është i regjistruar aplikuesi.
- Dëshmi nga aplikuesi se nuk është nën falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore – kërkohet origjinali jo më i vjetër se 30 ditë.
- Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.
- Gjendjen e xhirollogarisë bankare të aplikuesit për vitin e fundit (2023). Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme.
- Projekt-propozimin që përfshin: qëllimin, aktivitetet e projektit, koston financiare, planin kohor të realizimit të projektit dhe strukturën organizative të aplikuesit.²
- Të mos ketë pranuar mjete nga burimet tjera të financimit për të njëjtat aktivitete, (e dëshmuar me deklaratë nën betim).
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINT për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratë nën betim).

Në harmoni me kriteret e lartpërmendura, pako e aplikuesit duhet të përmbajë:

- Shtojcën A – Aplikacioni – Projekt Propozimin (shkarko LINKU)
- Shtojcën B – Deklarata nën Betim (shkarko LINKU)
- Dhe të gjithë dokumentet e kërkuar më lart

¹ Lista e punëtorëve për vitin 2023 e lëshuar nga ATK me emrin e subjektit aplikues në harmoni me NUI.

² Forma e projekt propozimit që duhet të plotësohet mund të shkarkohet nga portali e-Kosova.

Sqarim:

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar me lartë, përfshirë shtojcat, subjektet aplikuese do të diskualifikohen dhe nuk do të shqyrtohen për vlerësim.

5. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit nuk mund të tejkalojë katër (4) muaj që nga nënshkrimi i kontratës ndërmjet dy palëve (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës apo raportit të komisionit monitorues).

6. Sqarime shtesë

- Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- Ndërmarrja përfituese pas shërbimit të pranuar nga ofruesi i shërbimeve, obligohet që të paguaj ofruesin e shërbimeve në vlerën totale sipas klasifikimit të shërbimit digjital. Më pas ndërmarrja përfituese do të rimbursohet nga IFD-ja në bazë të përqindjeve sipas klasifikimit dhe madhësisë së qarkullimit.
- NVM-të që kanë përfituar subvencionim nga skema paraprake e digjitalizimit (IFD), nuk mund të përfitojnë në këtë skemë për shërbimin e njëjtë digjital.
- Në rast që ndërmarrja do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe, pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- Përfitues do të jenë ndërmarrjet që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht prej limiteve buxhetore të planifikuara.
- Ndryshimi i shërbimit të digjitalizimit mund të bëhet vetëm në koordinim dhe aprovim nga konsulenti i diagnostifikimit.
- Në ueb të MINT/KIESA do të publikohet lista e ndërmarrjeve të vlerësuara.

7. Si të aplikohet?

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen e MINT dhe të KIESA-së:

□ <https://mint.rks-gov.net/>

□ <http://kiesa.rks-gov.net/>

Aplikimi bëhet përmes platformës e-Kosova. Afati për dorëzimin e aplikacionit dhe dokumenteve përcjellëse është deri më datë 19.04.2024. Ndërsa, informatat shtesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net konform U.A.01/2018, jo më vonë se pesë (5) ditë para mbylljes së thirrjes publike.

8. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë të ndara në dy pjesë: Kriteret sektoriale dhe kriteret sociale.

Kriteret sektoriale: Përparësi do t'u ofrohet ndërmarrjeve që operojnë në prodhim, që eksportojnë ose kanë potencial për eksport dhe që krijojnë vende të reja pune. Maksimumi i pikëve që mund fitohen është 50 pikë. Ndërsa minimumi i kërkuar është 22.5 pikë. Shkalla e vlerësimit është: 10 më e larta – 1 më e ulëta.

Kategori	Kriteret specifike	Pesha	Vlerësimi (1-10)	Vlerësimi i peshuar
Kriteret e sektorit				
	Prodhim (20) apo Shërbime (15)			
	Eksport	10		
	Krijim i vendeve të punës	20		
			Totali	

Kriteret Sociale: Përparësi do t'u ofrohet ndërmarrjeve që do të kenë ndikim në punësimin e grave, të varfërve dhe minoriteteve. Po ashtu përparësi do të kenë ndërmarrjet në pronësi të grave, minoriteteve, dhe atyre që përdorin mjete apo metoda të energjisë së ripërtërishme dhe që operojnë në vise jo të zhvilluara. Maksimumi i pikëve që mund fitohen është 50 pikë. Ndërsa minimumi i kërkuar është 15 pikë. Shkalla e vlerësimit është: 10 më e larta – 1 më e ulëta, përveç kur është specifikuar ndryshe.

Kategoria	Kriteret specifike	Pesha	Vlerësimi (1-10)	Vlerësimi i peshuar
Kriteret sociale				
	Ndikimi pro-femrave	10		
	Ndikimi pro-varfërisë	10		
	Ndikimi pro-pakicave	6		
	Zonat me zhvillim më të ulët	6		
	Ndërmarrëset femra	Po (9) / Jo (0)		
	Ndërmarrësit pakica	Po (4) / Jo (0)		
	Ndërmarrësit ne ekonomi te gjelbert, energji te rinovueshme	Po (5) / Jo (0)		
			Totali	

9. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me UA 01/2018, në platformën e-Kosova.

Shënim:

Në rast se informatat e dhëna në këtë aplikacion vërtetohen që janë të pa sakta, subjektit nuk do t'i realizohet pagesa dhe i njëjti do të mbaj përgjegjësi për të gjitha pasojat, sipas legjislacioneve relevante në fuqi.

Iniciativa për Fuqizim Digjital përkrahet nga “Enabling Income Generation for the Poor”, projekt i financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC) dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Ky projekt zbatohet së bashku nga CARE International dhe ECIKS.